



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.75 Akti

Nr. 155 Vendimi

Tiranë, më 10.6.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	Kryesues
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator
<b>Pamela Qirko</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në datat 6 maj dhe 7 qershor 2019, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**

**Z. Fuat Vjerdha**, gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Apelit Shkodër, pa përfaqësues.

**OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit, z. Fuat Vjerdha, i cili në seancën dëgjimore publike, në datën 7.6.2019, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- a. Z. Fuat Vjerdha, për shkak të funksionit të tij si gjyqtar dhe kryetar në Gjykatën e Apelit Shkodër, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016<sup>1</sup>;
- b. Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 4 – i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici – pasi administroi dhe studioi tre raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 30.1.2018, vendosi:  
i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji;  
ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykues, komisioner Olsi Komici. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit;
- c. Më pas, për arsye objektive pamundësie, në bazë të vendimit nr. 40, datë 16.7.2018, “Për rishpërndarjen me short dhe transferimin e dosjeve të çështjeve të komisionerit Alma Faskaj” nëpërmjet procedurës së shortit, anëtarja e trupit gjykues, komisioner Alma Faskaj, u zëvendësua nga komisioner Pamela Qirko;
- d. Në vijim të hapave hetimorë, me vendimin nr. 2, në datë 17.4.2019, trupi gjykues vendosi të mbyllë fazën hetimore dhe në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për z. Fuat Vjerdha, të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit dhe përkatësisht të kontrollit të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale;
- e. Në datën 18.4.2019, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 21.3.2019; (iii) për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 – 47, të Kodit të Procedurës Administrative;
- f. Në datën 29.4.2018, subjekti i rivlerësimit – pasi ishte njohur me të gjithë materialin e ndodhur në dosje, në bazë të të cilit ishin arritur rezultatet e hetimit – paraqiti shpjegimet e tij të shoqëruara me dokumentacion mbështetës mbi rezultatet e hetimit kryesisht;

---

<sup>1</sup> Paragrafi 3, i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: “Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*”.

- g. Në datën 30.4.2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftojë – përmes postës elektronike – subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 6.5.2019 – datë në të cilën u zhvillua rregullisht seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent, pa përfaqësues;
- h. Po në datën 6.5.2019, pas zhvillimit të seancës, trupi gjykues mori dijëni mbi një denoncim – që ishte paraqitur nga publiku lidhur me një çështje gjyqësore të shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit – si dhe mbi një tjetër çështje, e cila ishte bërë publike edhe nga mediat;
- i. Në datën 7.5.2019, në sajë të sa më lart si dhe të nevojës për një qartësim të mëtejshëm të një rrethane që lidhej me deklaratimet *cash*, trupi gjykues vendosi që të riçelë hetimin administrativ, duke e njoftuar menjëherë subjektin në lidhje me këtë vendimmarrje;
- j. Më 24.5.2019, trupi gjykues vendosi rimbylljen e hetimit administrativ dhe në datën 27.5.2019, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e reja/shtesë të fazës së dytë të hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 21.03.2019;
- k. Në datën 1.6.2019, subjekti i rivlerësimit pasi ishte njohur me materialin e ri në dosje, prej datës 28.5.2019, paraqiti shpjegimet e tij të shoqëruara me dokumentacion mbështetës mbi rezultatet shtesë të hetimit administrativ;
- l. Në datën 5.6.2019, trupi gjykues vendosi të ftojë – përmes postës elektronike – subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 7.6.2019 – datë në të cilën edhe kjo seancë e dytë dëgjimore u zhvillua rregullisht, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent dhe paraqiti shpjegimet e tij.

## II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Të dyja seancat dëgjimore – më 6 maj dhe 7 qershor 2019 – për subjektin e rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha, u zhvilluan në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, edhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot;
- ii. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni – përgjatë të dyja fazave të hetimit administrativ të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit – dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime;
- iii. Në të dyja seancat, z. Fuat Vjerdha, pasi dëgjoji relacionin, shprehu qëndrimin e vet, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij;
- iv. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, gjatë seancave dëgjimore, u përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar dhe shprehu qëndrimin e tij përfundimtar të argumentuar – ku subjekti kërkoi konfirmimin e tij në detyrë;
- v. Në përfundim të seancës së dytë dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konkludojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin Fuat Vjerdha, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit;

- vi. Seanca e dytë dëgjimore e datës 7.6.2019 u ndërpre, për të rifilluar në datën 10.6.2019 për shpalljen e vendimit.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Z. Fuat Vjerdha ka mbajtur një qëndrim bashkëpunues me Komisionin, duke dhënë përgjigje sa herë është pyetur dhe ka paraqitur dokumentacion mbështetës për shpjegimet e tij, edhe në lidhje me burimet financiare të personave të tjerë, me të cilët ai kishte pasur marrëdhënie financiare.

### **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, ‘Vetting’”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) raportet dhe informacionet mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik me Komisionin;
- d) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve me të parashtruara nga subjekti në seancën dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit;
- e) deklaratimet e personave të lidhur apo të tjerë të lidhur;
- f) faktet e njohura botërisht.

### **A. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË**

Bazuar në nenet 30 - 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.1.2018, raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha, ku konstatohet se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### **Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e

burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

**1. Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për rivlerësim, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si vijon:**

- **dy apartamente** të lidhur me njëri-tjetrin me sip. 175 m<sup>2</sup>, me vlerë **të deklaruar 87,500 euro**;
- **një garazh** me sip. 35 m<sup>2</sup>, me vlerë **të deklaruar 10,000 euro**;
- **një dyqan** me sip. 41 m<sup>2</sup>, me vlerë **të deklaruar 61,500 euro**.

- i. Të gjitha këto pasuri ndodhen në “\*\*\*\*”, kompleksi \*\*\*, Shkodër, dhe janë trashëguar nga nëna e subjektit, e cila kishte lidhur kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., si bashkëpronare e truallit;
- ii. Megjithëse kanë kaluar mbi katër vjet që nga nisja e posedimit të tyre nga subjekti i rivlerësimit, këto pasuri nuk janë regjistruar në ZVRPP-në Shkodër në emër të subjektit. Gjithashtu, shoqëria ndërtuese nuk ka nënshkruar ende kontratën përfundimtare të shkëmbimit me secilin bashkëpronar të truallit, përfshirë edhe subjektin – në cilësinë e trashëgimtarit – për të mundësuar kalimin e pronësisë;

Komisioni, pasi ka kryer verifikimet e duhura lidhur me këto pasuri, ka konstatuar se:

- iii. Në datën 11.11.2013 është lidhur kontratë këmbimi nr. \*\*\*, midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositëseve, njëkohësisht edhe pronarë të truallit;
- iv. Si palë porositëse në këtë kontratë, veç të tjerëve, rezultonte edhe znj. M. T (V.) – nëna e subjektit;
- v. Nga kjo kontratë rezultonte se znj. M. V, nga ndërtimet e planifikuara do të përfitonte pasuritë: nr. \*\*\* me sip. 69 m<sup>2</sup>; nr. \*\*\* me sip. 105.8 m<sup>2</sup> dhe nr. \*\*\* me sip. 17.22 m<sup>2</sup>;
- vi. Gjithashtu, në këtë kontratë specifikohet se është përcaktuar që pronarët e lartpërmendur marrin në pronësi të plotë apartamentet dhe garazhet të përcaktuara si më lart; se kanë të drejtën e tjetërsimit të objekteve që ndodhen në dy godinat e ndërtuara – të cilat janë të certifikuara nga ZVRPP-ja Shkodër;
- vii. Nga dokumentacioni ligjor i administruar mbi legjitimitetin e subjektit Fuat Vjerdha, ai rezultonte trashëgimtar i vetëm i pasurisë së nënës së tij. Konkretisht, kjo bazohet në vendimin për dëshmi trashëgimie (me nr. \*\*\*) në datën 14.9.2016 të lëshuar nga noteri A. K. Në këtë vendim subjekti rezulton si trashëgimtar i vetëm i pasurisë të nënës së ndjerë, për shkak se babai i tij kishte hequr dorë nga trashëgimia e ish-bashkëshortes së vet<sup>2</sup>;

---

<sup>2</sup> Heqja dorë e babait të subjektit nga trashëgimia e ish-bashkëshortes është bërë në të njëjtin vendim të noterit, por edhe me anë të deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 14.9.2016, e cila ndodhet në dosjen e ILDKPKI-së.

- viii. Nga një vlerësim paraprak rezultoi se objekti në fjalë ka përfunduar së ndërtuari dhe se sipërfaqet e përcaktuara për subjektin e rivlerësimit nuk përkojnë me sipërfaqet e përfituara dhe të deklaruara nga subjekti;
- ix. Në vijim, është kërkuar informacion dhe administrimi i kontratës së plotë të këmbimit dhe i vërtetimit të sipërfaqes së përfitur nga subjekti i rivlerësimit. Konkretisht, janë kërkuar të dhëna nga noteri dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. për vënien në dispozicion të dokumentacionit të plotë që disponojnë;
- x. Me shkresën e datës 30.4.2018, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka deklaruar se është lidhur kontratë sipërmarrjeje në datën 4.10.2006, me objekt, shkëmbim titulli pronësie 80 % të truallit me 20 % të titullit të pronësisë së ndërtimit me familjen T..
- xi. Në datën 11.11.2013 është hartuar kontrata e këmbimit, ku theksohet se e ëma e subjektit të rivlerësimit gëzon të drejtat e posedimit të pasurive:
  - a. nr. \*\*\*, z.k. \*\*\*, me sip. 69 m<sup>2</sup> (sip. banimi), datë 10.5.2012;
  - b. nr. \*\*\*, z.k. \*\*\*, me sip. 105.8 m<sup>2</sup> (sip. banimi), datë 10.5.2012;
  - c. nr. \*\*\*, z.k. \*\*\*, me sip. 17.22 m<sup>2</sup> (sip. garazh), datë 10.5.2012;
- xii. Objekti i ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. – një pjesë e të drejtave të posedimit të sipërfaqeve respektive të ndërtimit do t’i kalojnë subjektit – nuk është realizuar ende. Gjithsesi, z. Fuat Vjerdha, gëzon pasuritë e përfituara me anë të kontratës së këmbimit si më sipër + garazh me sip.18.78 m<sup>2</sup> dhe njësi tregtare me sip. 41 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja totale e përfitur nga këmbimi i truallit në pronësi të subjektit me sip. ndërtimi është 245.8 m<sup>2</sup>. Gjithashtu, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. thekson faktin se nuk është realizuar përfundimisht kontrata e këmbimit me pronarët e truallit të familjes T. dhe për rrjedhojë, as regjistrimi i pasurive në ZVRPP-në Shkodër.
- xiii. Për sa më lart, Komisioni konstatoi mospërputhje midis sipërfaqeve të deklaruara nga subjekti në deklaratën “Vetting”, me sipërfaqet e pasqyruara në kontratën e këmbimit, si dhe sipërfaqeve të konfirmuara nga shoqëria ndërtuese.
- xiv. Nuk janë konstatuar problematika në lidhje me burimin e ligjshëm të këtyre pasurive, për shkak se subjekti i ka përfitur si trashëgimi, të cilat rrjedhin nga një kontratë shkëmbimi të truallit në pronësi të familjes, me sipërfaqe respektive të ndërtimit siç është bërë për të gjithë bashkëpronarët e tjerë.

### **1.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

- xv. Lidhur me sa më lart, subjekti ka pohuar se mospërputhja e sipërfaqeve ndërtimore, që do t’i përkisnin nënës së tij, të pasqyruara në aktet në fjalë, mund të shpjegohet me faktin se bëhet fjalë për ndërtimin e katër pallateve dhe jo vetëm të dy prej tyre, siç është përshkruar në njëren prej kontratave;
- xvi. Gjithashtu, subjekti ka specifikuar se realisht sipërfaqja totale e ndërtimit të realizuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. rezulton të jetë më e madhe nga ajo e parashikuara, pasi kjo shoqëri ka ndërtuar përtej limiteve të parashikuara në kontratën fillestare. Për rrjedhojë, në funksion të përfitimit të sipërfaqes ndërtimore nga porositësit, në përpjesëtim me totalin e ndërtuar, ka

pritsmëri që të përfitohet edhe një apartament më shumë, me sip. 120 m<sup>2</sup>, i cili mendohet t'i jepet dajës së tij/subjektit.

## 1.2 Vlerësimi i trupit gjykues

- xvii. Trupi gjykues vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me burimin e këtyre pasurive, pasi ato subjekti i ka të trashëguara. Megjithatë, konstatohet një mospërputhje dhe një konfuzion në lidhje me deklaratimet e kryera nga subjekti mbi sipërfaqet ndërtimore që do t'i kalojnë atij në pronësi, si dhe midis përmbajtjes së kontratave të shkëmbimit dhe deklaratimeve të kryera nga subjekti në seancë dëgjimore dhe në prapësimet e tij;
- xviii. Subjekti, nëpërmjet shpjegimeve të tij, shprehu pritsmërinë konkrete që sipërfaqja ndërtimore që do të përfitohej nga trashëgimia e tokës ku kishte ndërtuar shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ndryshe nga sa ishte parashikuar në kontratat e shkëmbimit, do të rritej me sip. 120 m<sup>2</sup> (pra një apartament më shumë);
- xix. Shtimi i sipërfaqes ndërtimore që do të përfitohej u shpjegua nga subjekti si një pasojë/efekt i realizimit nga shoqëria ndërtuese të një kubature/sipërfaqeje totale ndërtimore *de facto* më të madhe se ajo e parashikuar në lejen e ndërtimit dhe në kontratat fillestare, dhe duke qenë se sipërfaqja e ndërtuar që do të përfitohej nga pronarët e truallit ishte parashikuar në raport të drejtë (80% me 20%) me sipërfaqen totale ndërtimore, rrjedhimisht shtimi në rrugë e sipër i vëllimit total të ndërtuar passjell edhe shtimin e përfitimit që u përket bashkëpronarëve të truallit mbi të cilin është ndërtuar;
- xx. Për sa më lart, edhe pse në pamje të parë duket pa problematika, trupi gjykues vlerëson se nga këndvështrimi kontraktor – që pasqyron vullnetin e lirë të palëve në kryerjen e një veprimi juridik – mund të kemi të bëjmë me një objekt pjesërisht të cunguar nga paligjshmëria, nëse ndërtimi shtesë mbi katër pallatet/godinat e ndërtuara nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. është realizuar përtej limiteve të përcaktuara nga leja përkatëse e ndërtimit;
- xxi. Gjithsesi, në mungesë të elementeve të qarta dhe të provës konkrete mbi përfshirjen e dyshimtë në një përfitim të paligjshëm (në origjinë) – i cili aktualisht është vetëm i pritshëm nga subjekti – trupi gjykues çmon se kjo rrethanë nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi, z. Fuat Vjerdha.

## 2. Të ardhurat nga qiradhënia e dyqanit

Subjekti ka deklaruar se disponon të ardhura nga dyqani me sip. 41 m<sup>2</sup>, i dhënë me qira në vlerën 18,000 lekë/muaj, nga nëna e tij.

Pasi Komisioni ka kryer verifikimet e duhura lidhur me këtë pasuri ka rezultuar se:

- i. Në datën 29.12.2014 është lidhur kontratë qiraje midis qiradhënëses M. V dhe qiramarrësit A. H;
- ii. Në këtë kontratë është përcaktuar se qiradhënësja është pronare e një sipërfaqeje ndërtimore rreth 52 m<sup>2</sup> në katin përdhes, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, sipas kontratës së këmbimit nr. \*\*\*,

datë 11.11.2013, e cila është në proces nxjerrjeje të certifikatës së pronësisë. Afati i kontratës është 1 vit me të drejtë ripërtëritjeje dhe vlera e qirasë është caktuar 18,000 lekë/muaj;

- iii. Fillimisht, ishte vënë në dispozicion kontrata nr. \*\*\*, me të dhënat e noterit A. K, por mungojnë elementët përkatës, përshirë firma dhe vula e tij. Pra, është paraqitur një dokument që pretendohet se ishte lidhur nga palët pranë një noteri, por mungonin elementet thelbësore të aktit noterial, të domosdoshme për të mundësuar gjenerimin/passjelljen e efekteve të plota ligjore të këtij veprimi juridiko-tregtar;
- iv. Për qartësimin e situatës së mësipërme, Komisioni ka kërkuar të dhëna dhe dokumentacion nga noteri në fjalë, i cili ka përcjellë kontratën e qirasë të sipërcituar të lidhur për pasurinë që aktualisht e ka në pronësi subjekti i rivlerësimit;
- v. Gjithashtu, është kërkuar informacion edhe nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, lidhur me pagimin ose jo të detyrimeve tatimore në buxhetin e shtetit (tatim në burim);
- vi. Lidhur me këtë fakt, ILDKPKI-ja ka theksuar se në aktin përfundimtar të kontrollit se pas verifikimit dhe përgjigjes së drejtorisë së tatimeve, ka rezultuar se nuk janë paguar detyrimet për këtë kontratë qiraje dhe është mjaftuar vetëm me deklarinimin se vlerat e deklaruara në këtë kontratë nuk do të përfshihen në llogaritjen e burimeve financiare të ligjshme;
- vii. Pas hetimit të kryer nga Komisioni ka rezultuar se – sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër – detyrimin tatimor në fjalë e ka paguar pjesërisht subjekti qiramarrës.

## **2.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

- viii. Lidhur me sa më lart, subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm faktin që rezultojnë të paguara të gjitha tatimet mbi të ardhurat e gjeneruara nga kontrata e qirasë për dyqanin në fjalë, së paku përgjatë periudhës që subjekti ka qenë pronar (sipas dhe në saje të aktit të trashëgimisë);
- ix. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur disa dokumente mbështetëse të qëndrimit të tij, të cilat ishin lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, nëpërmjet të cilave vërtetohet pagesa e tatimit mbi fitimin e gjeneruar nga dhënia me qira e dyqanit në fjalë – së paku për të gjithë periudhën gjatë të cilës, z. Fuat Vjerdha, rezultonte si pronar i tij.

## **2.2 Vlerësimi i trupit gjykues**

Trupi gjykues çmon se shpjegimet dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pikë janë bindëse dhe mund të konsiderohen si burim i ligjshëm i të ardhurave të përfituara nga subjekti nëpërmjet dhënies me qira të dyqanit me sip. 52 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Shkodër – për sa i përket periudhës që z. Fuat Vjerdha ka qenë pronar i tij.

## **3. Pasuria e përfituar me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë**

Subjekti ka deklaruar se nëna e tij ka qenë përfituese nga vendimi nr. \*\*\*, datë 5.11.1995, i KKKP-së Tiranë. Me anë të këtij vendimi i njihet e drejta e kompensimit trashëgimtarëve “\*\*\*\*”, e truallit me sip. 965.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në “\*\*\*\*”, Tiranë, mbi të cilin është ndërtuar \*\*\*.



Pas verifikimit të dokumentacionit të dosjes dhe shpjegimeve të subjektit ka rezultuar se:

- i. KKKP-ja Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.11.1995, ka vendosur të njohë dhe të kompensojë trashëgimtarët ligjorë të ish-pronarëve, H. T. dhe 5 të tjerë, për truallin e zënë me ndërtime me sip. 965.7 m<sup>2</sup> në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji nr. 7698, i vitit 1993;
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion të mëtejshëm për kompensimin e kësaj prone dhe as ka përmendur ndonjë vlerë financiare për të analizuar këtë pasuri;
- iii. I pyetur nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar që, edhe pse është dhënë vendimi i kompensimit, përfituesit nuk e kanë marrë ende atë, pra, vendimi nuk është ekzekutuar ende;
- iv. Trupi gjykues nuk konstatoi problematika lidhur me këtë rrethanë, pasi, duke mos u konkretizuar nëpërmjet ekzekutimit të vendimit në fjalë, nuk ka prodhuar/shkaktuar ende asnjë efekt mbi burimet financiare të subjektit.

#### **4. Autoveturë, tip “Daimler-203-CDI”, në pronësi të subjektit**

Subjekti, në deklaratën “Vetting”, veç të tjerash, ka deklaruar se disponon edhe autoveturën e markës “Daimler-203-CDI”, ngjyrë gri, e vitit 2001, me targë \*\*\*, në bashkëpronësi me bashkëshorten e vet. Mjeti është blerë sipas kontratës së blerjes së datës 16.4.2014 me vlerë 290,000 lekë.

Pas verifikimeve dhe hetimeve të Komisionit ka rezultuar se:

- i. Sipas lejes së qarkullimit rrugor dhe të dhënave lidhur me të, pronarë të mjetit me specifikimet e mësipërme janë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij. Kontrata e shitblerjes është lidhur nga noteri V. H., në datën 16.4.2014. Shitës është R. K. dhe blerës janë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij. Vlera e blerjes së mjetit ka qenë 290,000 lekë, e cila është likuiduar tërësisht midis palëve;
- ii. Ky mjet figuron i regjistruar për herë të parë në Shqipëri në vitin 2010 dhe më pas i është shitur subjektit të rivlerësimit në vitin 2014;
- iii. Ka rezultuar se ky automjet është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën periodike për vitin 2014, **por aty nuk është deklaruar burimi i krijimit të të ardhurave për blerjen e tij;**
- iv. Subjekti deklaroi që ka kryer saktë çdo deklaram, duke mos dhënë shpjegim bindës dhe konkret lidhur me mangësinë e konstatuar nga Komisioni;
- v. Për rrjedhojë, rezulton i paplotë deklarimi periodik i vitit 2014, paraqitur në ILDKPKI.

Komisioni çmon se ky fakt duhet të konsiderohet si një pasaktësi, i cili nuk mund të passjellë pasoja në vetvete, por që duhet mbajtur parasysh në një vlerësim tërësor, mbi qasjen e subjektit në lidhje me deklaramet e kryera prej tij.

#### **5. Analiza financiare**

- i. Sipas rezultateve përmbledhëse të analizës financiare për subjektin e rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha, duke u bazuar në deklaratën “Vetting”, në dokumentet zyrtare lidhur me të ardhurat e subjektit dhe të familjarëve të tij, në shkresat e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, në dokumentacionin e ardhur nga ZRPP-ja dhe institucionet e tjera shtetërore e private, kontratat

dhe deklarimet noteriale, si dhe duke vlerësuar burimet financiare të ligjshme në krahasim me investimet, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara nga subjekti, apo të konstatuara nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme financiare për blerjen e pasurive të deklaruara, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera prej tij dhe familjes së tij;

- ii. Por, sipas përlllogaritjeve dhe analizës së kursimeve *cash*, sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti lidhur me mënyrën e deklarimit të tyre<sup>3</sup>, dhe duke i marrë të mirëqena këto pohime, rezulton se deri në fund të vitit 2016 subjekti ka realizuar shumën prej **1,582,029 lekësh** si kursime *cash* – pasi ai nuk ka deklaruar asnjë pakësim të gjendjes *cash* në banesë – dhe shumën prej **2,717,971 lekësh**, si kursime të cilat ishin gjendje në llogaritë bankare;
- iii. **Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm shumën prej 200,000 lekësh si gjendje *cash* në banesë.** Pra, rezulton një diferencë prej **1,382,029 lekësh** vetëm mes gjendjes së kursimeve *cash* të grumbulluara në fund të vitit 2016, dhe shumës së kursimeve *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratën “Vetting”;

### 5.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- iv. Për këto mospërputhje subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion lidhur me:
  - a. Lëvizjet bankare që pasqyrojnë gjendjet monetare në llogaritë bankare të babait të subjektit, z. S. V, dhe konkretisht: në “BKT” me gjendje 5,744 USD – dokument i lëshuar më 14.10.2016; dhe në llogarinë në “Tirana Bank” – me gjendje 634,283 lekë – dokument i lëshuar më 11.10.2016;
  - b. Faturën në vlerën prej 135,000 lekësh të datës 5.9.2017 dhe mandatarkëtimin në vlerën prej 1.100 eurosh, të datës 10.6.2017, nga ku rezulton se pagues është z. S. V, babai i subjektit – lidhur me disa shpenzime të kryera prej tij.
- v. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit – pasi ka pranuar ekzistencën e diferencës në vlerën prej 1,683,129 lekësh midis deklarimit të vitit 2016 dhe deklaratës “Vetting” (*cash* plus kursime në gjendjen bankare) – ka shpjeguar se ai banon së bashku me babanë dhe në momentin e deklaratës “Vetting”, ky i fundit ka disponuar shumat e sipërcituara (në pikat “a” dhe “b”), të cilat, së bashku shkojnë në vlerën prej 1,612,283 lekësh. Këto shuma nuk janë deklaruar në deklaratën “Vetting”, pasi babai i subjektit – sipas subjektit – nuk ka pasur detyrimin për të bërë deklarime;
- vi. Së fundmi, subjekti shton se dokumentacioni bashkëngjitur, lidhur me depozitat/gjendjet bankare të babait të tij, është grumbulluar prej tij, për deklaratën “Vetting”, në vitin 2016;

### 5.2 Vlerësimi i trupit gjykues

- vii. Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti vlerësohet si pa efekt dhe i parëndësishëm lidhur me analizimin e kësaj pike, për këto shkaqe:
  - a. Lëvizjet bankare nuk vërtetojnë gjendjen e shumave të babait të subjektit në datën e deklaratës “Vetting”, madje as në datën 31.12.2016, pasi dokumentet provuese datojnë më herët;

---

<sup>3</sup> Çdo vit janë deklaruar vetëm kursimet shtesë të realizuara përgjatë atij viti, por duke përfshirë aty së bashku, si shtesat e kursimeve *cash* në banesë, edhe shtesat e gjendjes në llogaritë bankare.

- b. Edhe nëse kjo gjendje parash do të provohej në këto data, gjithsesi nuk mund të mbulonte kursimet e deklaruara nga subjekti, pasi gjendjet e babait të subjektit presupozohet që të rrjedhin prej kursimeve të këtij të fundit<sup>4</sup> – në mungesë të një deklarate huadhënieje apo dhurimi nga ana e subjektit. Në të kundërt, mund të hamendësohej një mungesë deklarimi dhe fshehjeje pasurie, nëse subjekti do të pretendonte se shumat në fjalë që ka poseduar dhe posedon babai i tij kanë prejardhje nga burimet financiare të subjektit dhe jo të babait të tij;
  - c. Në çdo rast, gjendjet bankare të z. S. V. datojnë të depozituara shumë më herët se deklaratat nën vlerësim krahasimor dhe nuk mund të ndryshojnë rezultatin – siç mund të hamendësohej nëse ato do të ishin depozituar pas datës 31.12.2016 dhe përpara deklaratës “Vetting”. Por, edhe në këtë rast, ky spostim (i mundshëm) shumash monetare nga djali te babai do të duhej të ishte pasqyruar në deklaratën e vitit 2017;
  - d. Shpenzimet e kryera nga z. S. V. në muajin qershor dhe shtator 2017, nuk kanë lidhje me diferencën midis deklaratës 2016 me deklaratën “Vetting”, pasi ato janë kryer disa muaj pas kësaj të fundit;
  - e. Edhe në rast se subjekti me depozitimim e këtyre dokumenteve ka dashur të vërtetojë gjendjen financiare *cash* të babait të vet në momentin e deklaratës “Vetting”, nga njëra anë ky fakt mund të konsiderohet i mundshëm, por jo i provuar, pasi shumat e shpenzuara mund të jenë fituar përgjatë muajve pas deklaratës “Vetting”. Nga ana tjetër, edhe gjendje e mundshme *cash*, në momentin e deklaratës “Vetting”, nga z. S. V., nuk do të prodhonte asnjë efekt lidhur me justifikimin apo shpjegimin e diferencës në analizim, pasi – siç u tha edhe më lart – këto shuma do të kishin një burim të ndryshëm, që nuk lidhet me burimet dhe disponibilitetet financiare të subjektit.
- viii. Komisioni, përveç sa më lart, ka konstatuar se në deklaratën e vitit 2017 subjekti ka deklaruar shpenzime shëndetësore, të cilat janë përballuar nëpërmjet përdorimit të shumave të tërhequra nga një depozitë bankare, të cilën subjekti, më herët, e kishte investuar në bono thesari. Por ai, as në këtë vit, nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*;
  - ix. Për rrjedhojë, sipas deklarimeve të subjektit, shumatorja e kursimeve *cash* të deklaruara ndër vite, së bashku me pjesën e shumave të tjera, po ashtu të kursyera ndër vite, por që ishin gjendje në llogaritë bankare, në datën 31.12.2016, rezulton që të ketë qenë në shumën **4,300,000 lekë**;
  - x. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti, përgjatë javëve të para të vitit 2017, deri në paraqitjen e deklaratës “Vetting”, ka përballuar disa shpenzime mjekësore në shumën prej 1,140,069 lekësh;
  - xi. Gjithashtu, në datën e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, subjekti kishte likuiditete në vlerën 1,000,000 lekë në llogarinë bankare depozitë dhe në vlerën 276,802 lekë në llogarinë rrjedhëse;
  - xii. Po ashtu, siç u tha edhe më lart, subjekti ka deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën “Vetting”, vetëm shumën prej 200,000 lekësh;
  - xiii. Duke zbritur nga shuma prej 4,300,000 lekë, shumat e sipërcituara (4.300.000 - 1,140,069 - 1,000,000 - 276,802 - 200,000 = 1,683,129), rezulton se kursimet *cash* në momentin e deklaratës “Vetting” kanë ekzistuar dhe do të duhej që të ishin deklaruar në shumën prej **1,683,129 lekësh, dhe jo në shumën prej 200,000 lekësh**, sa ka deklaruar z. Fuat Vjerdha;

<sup>4</sup> Nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar në vitet përkatëse, si shtim të kursimeve të veta, shumat e depozituara nga babai i tij në bankat e nivelit të dytë;

- xiv. Për rrjedhojë, kjo shumë prej **1,683,129 lekësh**, rezulton si shumatore e likuiditeteve që – sipas analizës së deklarimeve të mëparshme të subjektit – kanë qenë në dispozicion të tij, së paku deri në deklaratën “Vetting”, por që rezultojnë të padeklaruara prej tij;
- xv. Gjithashtu, duke analizuar dhe konsideruar edhe përmbajtjen e deklaratës të vitit 2017 – ku nuk janë deklaruar shpenzime apo pakësime të tjera, veç atyre të përlllogaritura më lart – arrihet në konkluzionin se kjo shumë (prej 1,683,129 lekësh) ka vijuar të jetë në dispozicion të subjektit edhe pas vitit 2017 (duke mos qenë e deklaruar si e shpenzuar), por ajo nuk është deklaruar si gjendje në deklaratën “Vetting”;
- xvi. Argumentimi alternativ i fakteve të mësipërme mund të na çonte në një vlerësim të saktë të deklarimit “Vetting”, por atëherë do të arrihej në konkluzionin se të gjitha deklaratimet vjetore, (ose së paku katër prej tyre<sup>5</sup>) lidhur me shtesën e kursimeve *cash* në banesë kanë qenë minimalisht të pamjaftueshme;
- xvii. Për sa më lart, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti lidhur me këtë pikë nuk janë bindëse, pasi ai ka tentuar të justifikojë pamjaftueshmëritë e deklaratave të tij nëpërmjet gjendjeve në llogari bankare dhe *cash* të babait të tij, si dhe me shpenzime të kryera nga ky i fundit disa muaj pas deklaratës “Vetting”. Të gjitha këto fakte dhe të dhëna lidhur me z. S. V., nuk mund të ndikojnë mbi sa është konkluduar nga Komisioni, pasi të ardhurat, kursimet, depozitat, gjendjet *cash* dhe shpenzimet e babait të vet, subjekti nuk i ka deklaruar ndonjëherë as në deklaratat vjetore, që të mund të krijojnë diferencën /mospërputhjen në fjalë;
- xviii. Për më tepër, vetë subjekti shprehet kontradiktor, kur nga njëra anë priret të justifikojë diferencën midis deklaratës së vitit 2016 dhe deklaratës “Vetting”, me mospasqyrimin e gjendjeve monetare dhe të shpenzimeve të babait të vet dhe, nga ana tjetër, duke pohuar se babai i tij nuk kishte detyrim për të deklaruar.

**Si konkluzion, në sajë të konstatimeve dhe të argumentimeve të shpjeguara më lart, Komisioni çmon se, si në prezencën e pamjaftueshmërisë së deklaratës “Vetting” – për mosdeklarimin e posedimit të likuiditeteve në shumën prej 1,683,129 lekësh – por edhe në rast se do të vlerësohej hipoteza alternative që do të na çonte përballë, së paku, katër deklarimeve vjetore të pamjaftueshme – që lidhen me shuma *cash* të deklaruara jo me vërtetësi, duke mos i poseduar realisht ato, – duhet aplikuar neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 3, e nenit 61, e ligjit nr. 84/2016.**

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

### **Rezultatet në lidhje me kontrollin e figurës**

- i. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar:

<sup>5</sup> Për shkak se për të arritur në shumën 1.683.129 lekë, që rezulton si diferencë midis shumave në gjendje *cash* plus likuiditete në bankë më 31.12.2016 – (në total 4.300.000 lekë) dhe 200.000 *cash* plus gjendjeve likuiditet në llogaritë bankare në datën e deklaratës “Vetting”, – do të duhej të konsideroheshin zero, së paku 4 deklarata vjetore të kursimeve *cash* (vjetore), mesatarisht nga 400.000 në 500.000 lekë;

*përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektin e rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha. Ky raport është deklasifikuar<sup>6</sup> në datën 20.2.2018;*

- ii. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- iii. Në datën 27.2.2019, Komisioni, në saje të disa denoncimeve të paraqitura nga publiku, si dhe të disa informacioneve të marra nga institucionet ligjzbatuese i kërkoi DSIK-së një përditësim të raportit në lidhje me figurën e subjektit;
- iv. Në datën 11.4.2019, DSIK-ja, përmes përgjigjes së saj konfirmon përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha;
- v. Nga dokumentacioni i verifikuar apo nga burime të tjera informacioni – përtej disa denoncimeve nga publiku që ngrinin dyshime, por që mbetën të paprovuara – nuk është provuar asnjë element i mjaftueshëm për të provuar ekzistencën e ndonjë rrethane që cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë integritetin e subjektit të rivlerësimit;
- vi. Nga hetimi administrativ i thelluar nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e ndonjë kontakti të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**Për rrjedhojë, Komisioni çmon se nuk ka elemente të mjaftueshme për të ndryshuar përfundimin e arritur nga DSIK-ja për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij, për sa i përket kriterit të figurës.**

## **C. RIVLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE**

### **I. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Inspektorati i KLD-së**

**Raporti për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Inspektorati i KLD-së është bazuar:**

- në formularin e vetëdeklarimit, në të tria dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- në pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- në të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

### **Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti**

Nga analiza e Inspektoratit të KLD-së për dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet:

- a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari është plotësuar sipas shtojcës së ligjit dhe është nënshkruar rregullisht në çdo faqe.

- b) Përvoja profesionale e 10 viteve të fundit

---

<sup>6</sup> Me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.7.2018.

Subjekti ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në vitin 1994; në datën 6.7.1995 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër; në datën 1.4.2005 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër; prej datës 19.7.2011 subjekti ushtron detyrën e kryetarit të Gjykatës së Apelit Shkodër.

c) Detyrat e kryera në tri vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha, gjatë tri viteve kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, ka ushtruar funksionin e kryetarit në Gjykatën e Apelit Shkodër. Ai ka marrë pjesë në gjykime civile dhe penale, si dhe në gjykime pranë Kolegjit Zgjedhor. Subjekti ka deklaruar se për tri vitet e fundit i janë caktuar 886 çështje ka përfunduar si relator 617 çështje, duke mbartur për vitin e fundit 131 çështje.

d) Trajnimet në tri vitet e fundit

Subjekti ka deklaruar se ka qenë pjesëmarrës në nëntë aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe ka paraqitur dy certifikata trajnimesh jashtë programit të shkollës.

e) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore të llojit *vendim gjyqësor*. Këto vendime janë të viteve 2015 dhe 2016.

### **Analiza e gjetjeve**

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit:

i) nga formulari i vetëvlerësimit;

ii) nga pesë dosjet e përzgjedhura me short; dhe

iii) nga të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

### **1. Aftësitë profesionale**

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, ndonëse në tekstin e vendimeve përfundimtare i përdor në raste të rralla (shihni dokumentin 1). Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se përgjithësisht ai identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në një rast është konstatuar se vendimi gjyqësor nuk përmban referenca ligjore dhe arsyet e zgjidhjes së çështjes janë dhënë me fjali përgjithësuese (shihni dosjen 3).

Kur është rasti, ai identifikon edhe ligjin e hershëm në kohë apo aktet nënligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (shihni dosjet 4 dhe 5).

Ka njohuri të procedurave të gjykimit në raport me llojin e çështjeve gjyqësore penale, civile apo zgjedhore që ka shqyrtuar.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, por në ndonjë rast janë konstatuar problematika të arsyetimit të vendimit, që lidhen me

mungesën e referencave gjyqësore, paqartësinë e argumenteve, analizën përgjithësuese të pretendimeve të palëve dhe lapsuse dhe gabime materiale në vendime. Niveli i arsytimit të vendimeve respekton përgjithësisht standardin e procesit të rregullt ligjor. Subjekti i kushton rëndësi vendimeve të ndërmjetme, të cilat arsyetohen dhe tregohet shkaku ligjor i tyre.

## **2. Aftësitë organizative**

### a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit gjatë tri viteve të fundit ka përfunduar së gjykuari 634 çështje, nga të cilat 135 çështje penale themeli, 216 çështje civile, 23 çështje administrative-civile, 42 çështje administrative-penale, 173 masa sigurimi personale dhe 45 çështje civile si shkallë e parë. Sipas këtyre të dhënave statistikore, konstatohet se ngarkesa sasiore e subjektit të rivlerësimit ka qenë mbi standardin minimal.

### b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Në 4 dosjet e vëzhguara gjykimet kanë qenë produktive, ndërsa në një rast 2 seanca kanë qenë joproduktive. Në 5 dosjet e shortuara seancat janë zhvilluar me vonesë, por 4 prej tyre kanë qenë me vonesë deri në 10 minuta. Gjatë gjykimit, subjekti identifikon veprimet procedurale që duhen kryer; merr mendimin e palëve dhe nxjerr urdhra të ndërmjetëm. Subjekti zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit duke ndjekur hapat proceduralë deri në dhënien e vendimit. Në ushtrimet e funksionit si kryetar i gjykatës janë identifikuar edhe disa problematika lidhur me shortimin e çështjeve dhe caktimin e përshpejtuar të seancës së parë gjyqësore. Ka pasur një ankesë dhe, pas verifikimit, janë konstatuar parregullsi në veprimet e subjektit, të cilat janë regjistruar për vlerësim profesional dhe etik.

### c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve të dosjes. Mangësitë janë relativisht të njëjta në mungesë të aktit formal për caktimin e seancës dhe mungesës së relacionit me shkrim. Procesverbali është sipas kërkesave të ligjit procedural, por në disa raste janë vërejtur mosdokumentime në vonesat për fillimin e seancave gjyqësore. Tri dosje janë të inventarizuara dhe dy të tjerat janë të painventarizuara.

## **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

### a) Etika në punë

Gjatë periudhës 3-vjeçare tetor 2013 – tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit ka pasur tri ankesa në KLD. Nga këto ankesa, vetëm një ankesë është verifikuar dhe kanë rezultuar vonesa në caktimin e seancës së parë gjyqësore të një çështjeje civile nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, për subjektin përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

### b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha dhe nga 5 dosjet e vëzhguara (me përjashtim të mangësive të evidentuara tek aftësitë organizative) konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha. Për vetë gjyqtarin Fuat Vjerdha, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Në një çështje penale ai ka shqyrtuar akuzën për dhunë në familje, ku ka evidentuar faktin penal dhe ka marrë në konsideratë një tërësi rrethanash, duke mos pranuar në fund ankimin e prokurorit për ashpërsimin e dënimit penal, por as ankimin e të pandehurit për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim (*shihni* dosjen 2). Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara nuk janë identifikuar çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Me përjashtim të mangësive të evidentuara tek aftësitë organizative, në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

#### 4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

##### a) Aftësia e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore dhe në akte tek 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është normale; komunikimi është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

##### b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit, z. Fuat Vjerdha për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në këtë aspekt duhet evidentuar se nuk ka pasur asnjë seancë gjyqësore të dështuar nga planifikimi për shkaqë të organizimit të trupit gjykues apo të stafit administrativ. Subjekti i rivlerësimit, në të 5 dosjet e vëzhguara, ka qenë pjesë e një trupi gjykues të formuar nga 3 gjyqtarë dhe ka bashkëpunuar me ta dhe administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale. Janë konstatuar 4 raste vonese në arsyetimin e vendimit dhe depozitimin e dosjes gjyqësore në sekretari, por vonesat kanë qenë të vogla dhe justifikohen me ngarkesën sasiore në punë të tij (*shihni* të dhënat tek aftësitë organizative).

##### c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha, gjatë 3 viteve të fundit, ka ushtruar funksionin e kryetarit të Gjykatës së Apelit Shkodër. Për shkak të kësaj detyre subjekti i nënshtrohet detyrimit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit subjekti ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 9 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se z. Fuat Vjerdha ka kryer 15 ditë të formimit vazhdues për 3 vjet. Gjithashtu, ai ka marrë pjesë edhe në 2 trajnime jashtë Shkollës së Magjistraturës që lidhen me aksesin në drejtësi (10 ditë) dhe me etikën gjyqësore (1 ditë). Lënda e trajnimeve brenda dhe jashtë Shkollës së Magjistraturës ka lidhje të mirë me funksionin e tij, pasi përmban jo vetëm çështje horizontale të sistemit gjyqësor, por synon edhe përditësimin e njohurive të tij me zhvillimet e fundit evropiane.



## **Informacioni i marrë nga KLD-ja**

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2018, është kërkuar informacion në KLD lidhur me dosjen personale, masat disiplinore dhe ankesat e publikut për subjektin Fuat Vjerdha. KLD-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2018, ka dërguar informacionin e kërkuar ku rezulton, ndër të tjera, se për këtë subjekt ka pasur 7 ankesa për periudhën janar 2016 – mars 2018.

### **1. Ankesa e shtetasit G. Ç.**

Ankuesi ka paraqitur ankesë ndaj subjektit në vitin 2008. Pas shqyrtimit nga Inspektorati i KLD-së është propozuar arkivimi i ankesës për shkak se nuk ka vend për verifikim. Për këtë praktikë është nxjerrë dhe urdhër arkivimi në datën 23.12.2008.

### **2. Ankesa e shtetasës Z. M.**

Ankuesja ka paraqitur ankesë ndaj subjektit në vitin 2009. Pas shqyrtimit nga Inspektorati i KLD-së është propozuar arkivimi i ankesës për shkak se nuk ka vend për verifikim, pasi këto pretendime të ankueses mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet rekursit të vendimit në Gjykatën e Lartë. Për këtë praktikë është nxjerrë dhe urdhër arkivimi në datën 23.7.2009, ku ankueses i është kthyer përgjigje në datën 31.7.2009.

### **3. Ankesa e shtetasit K. Dh.**

Ankuesi ka paraqitur ankesë ndaj subjektit në vitin 2013, për shkak se vendimet e tij janë rrezuar nga Gjykata e Apelit ku gjyqtari Fuat Vjerdha ka qenë pjesë e trupit gjykues. Pas shqyrtimit nga Inspektorati i KLD-së është propozuar arkivimi i ankesës, për shkak se nuk ka vend për verifikim, pasi këto pretendime të ankuesit nuk qëndrojnë. Kërkesa për arkivim është bërë për arsye se vendimet e subjektit të rivlerësimit nuk rezultojnë të jenë cenuar nga Gjykata e Lartë, gjë që do të përbënte objekt verifikimi apo kontrolli. Për këtë praktikë nuk është paraqitur nga KLD-ja urdhër arkivimi apo të rezultojë t'i jetë kthyer përgjigje ankuesit lidhur me arkivimin e ankesës.

### **4. Ankesa e shtetasit F. Sh.**

Ankuesi ka paraqitur ankesë ndaj subjektit në vitin 2013, për shkak të vonesave në një proces gjyqësor. Pas shqyrtimit nga Inspektorati i KLD-së është propozuar arkivimi i ankesës, pasi këto pretendime të ankuesit nuk qëndrojnë. Kërkesa për arkivim është bërë për arsye se me veprimet dhe mosveprimet subjekti nuk rezulton të ketë kryer shkelje. Për këtë praktikë është nxjerrë dhe urdhër arkivimi në datën 10.6.2013, ku i është kthyer përgjigje ankuesit në datën 11.6.2013, lidhur me arkivimin e ankesës.

### **5. Ankesa e shtetasit E. Sh.**

Ankuesi ka paraqitur ankesë ndaj subjektit në vitin 2017, për mosrespektim formal të ligjit. Pas shqyrtimit nga Inspektorati i KLD-së është propozuar arkivimi i ankesës, pasi këto pretendime të ankuesit nuk qëndrojnë. Kërkesa për arkivim është bërë për arsye se nuk vërtetohen fakte që kanë të bëjnë me mosrespektimin formal të ligjit dhe që mund të konsiderohen shkelje. Për këtë praktikë është nxjerrë dhe urdhër arkivimi, ku i është kthyer përgjigje ankuesit në datën 7.2.2017, lidhur me arkivimin e ankesës.

Lidhur me vlerësimet për masë disiplinore, sipas Inspektoratit të KLD-së në periudhën janar 2006 deri më sot nuk rezulton të jetë marrë ndonjë masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.

## II. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

### Denoncimet e publikut për subjektin e rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha

Nga ankesat, denoncimet dhe informacioni i ardhur nga publiku në Komision, bazuar në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha, rezulton se janë paraqitur 15 denoncime, nga të cilat disa nuk përmbanin përshkrimin e të dhënave sipas pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016. Ndërsa, lidhur me indicet e tjera janë administruar dhe studiuar një sërë dosjesh profesionale, si dhe janë dëgjuar mbi dhjetë persona (në cilësinë e denoncuesve apo të personave që njihnin apo që mund të njihnin faktet e denoncuar), të cilët kanë dhënë deklaratimet e tyre përpara trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar.

Komisioni, në bazë të neneve 40 – 44, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e Inspektoratit të KLD-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur – duke pasur parasysh faktin që janë paraqitur një numër i konsiderueshëm denoncimesh – ka kryer një rivlerësim tërësor të kriterit profesional, nëpërmjet një kombinimi të balancuar midis raportit të sipërpërmendur dhe vlerësimit të dosjeve, si dhe problematikave profesionale të denoncuar apo të konstatuara.

Duke qenë se rezultatet e arritura nga Inspektorati i Lartë i KLD-së u pasqyruan më sipër, Komisioni vijon me analizimin e komponentit tjetër të marrë në konsideratë nga trupi gjykues, së bashku me informacionet e tjera të administruara nga Komisioni, për të dalë në përfundim për këtë kriter rivlerësimi.

Komisioni ka thelluar hetimet duke kërkuar, administruar dhe studiuar aktet, vendimet dhe dosjet e disa çështjeve që lidheshin me indicet e mbërritura në Komision, që paraqisnin elemente konkrete dyshimi, nga analiza e të cilave ka rezultuar se:

### 1. Procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2017

- i. Nga studimi i dosjes gjyqësore rezultoi se me vendimin nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* akti, datë 30.3.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur:
  - a. deklarin fajtore të së pandehurës M. M. për kryerjen e veprës penale “*mashttrim*”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 12 vjet burgim;
  - b. në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës M. M. i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht e pandehura dënohet me 8 vjet burgim;
  - c. deklarin fajtore të së pandehurës F. M. për kryerjen e veprës penale “*mashttrim*”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim;
  - d. në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës F. M. i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri dënohet me 6 vjet e 8 muaj burgim.
- ii. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*) regj. dhe nr. \*\*\* vendimi, datë 18.10.2017, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues i trupit gjykues, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 30.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke u shprehur në këtë mënyrë:
  - a. deklarin e pafajshëm të së pandehurës F. M. për kryerjen e veprës penale “*mashttrim*” e parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal;
  - b. deklarin fajtore të së pandehurës M. M. për kryerjen e veprës penale “*mashttrim*” të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite e dënon atë me 6 vjet burgim;

- c. në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, e pandehura dënohet përfundimisht me 4 vjet burgim;
  - d. në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim për të pandehurën M. M., me kusht që për një periudhë kohe prej 4 vjetësh të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me zyrën vendore të shërbimit të provës Lezhë;
  - e. urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të së pandehurës M. M., nëse ndaj saj nuk ka të caktuar ndonjë masë sigurimi “arrest në burg” ose vendim dënimi me burgim të formës së prerë.
- iii. Në vendimin e saj Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë sqaron se sipas doktrinës juridike “*mashtrim*” përkufizohet si paraqitja e rreme e rrethanave ose e fakteve si të vërteta, kur ato objektivisht nuk janë të tilla, por nga ana tjetër, fshehin faktet dhe rrethanat e vërteta nga fajtori;
  - iv. Kjo gjykatë nuk thellohet dhe as nuk e analizon rolin dhe përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të shtetasit F. M, në pjesën arsyetuese të vendimit, por vetëm të bashkëshortes së tij, znj. M. M., edhe pse i konsideron të dy të përfshirë në bashkëpunim;
  - v. Gjithashtu, në dosje vihet re se Prokuroria e Rrethit Lezhë ka kryer një sërë veprimesh procedurale, akte ekspertimi, ka marrë dëshminë dhe provat e denoncuesit, por në dërgimin e çështjes në gjykatë, duket se nuk ka përdorur të gjitha provat e administruara dhe se nuk ka bërë një hetim/vlerësim të gjithanshëm dhe të thelluar, si dhe ka munguar në cilësimin e duhur dhe të plotë për të gjitha veprat penale të konstatuara, që mund të jenë kryer nga të dy të pandehurit dhe ndoshta, edhe në bashkëpunim me shtetas të tjerë<sup>7</sup>;
  - vi. Prokuroria, në rastin më të pakët, përveç kërkesës për shqyrtim të dosjes dhe dënimin për veprën penale të mashtrimit, duhet të kishte kërkuar në gjykatë edhe dënimin e të pandehurve për veprën penale të falsifikimit dhe/ose për moskallëzim krimi – nëse dokumentet e falsifikuara ishin prodhuar nga dikush tjetër, përtej bashkëshortëve;
  - vii. Kjo mangësi mund të ishte ngritur edhe nga gjykatat, si dhe të kërkohej zgjerimi i akuzave edhe gjatë gjykimit të kësaj çështjeje ose dosja të kthehej në prokurori, pasi gjatë fazës hetimore ka rezultuar e qartë se janë falsifikuar disa dokumente shkresore të institucioneve të ndryshme, akte noteriale dhe firma të subjekteve të tjera, duke filluar nga palët/pronarët, noteria, ZVRPP-ja etj.;
  - viii. Gjithsesi, lidhur me mangësitë që në rastin konkret i përkasin edhe subjektit të rivlerësimit, i cili ka qenë anëtar i trupit gjykues në Gjykatën e Apelit, e cila, veç mosevidentimit të mosveprimeve/mangësive si më lart, mosvlerësimit të provave në harmoni me njëra-tjetrën dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse vlen të theksohet se ka shpallur të pafajshëm shtetasin F. M., i cili kishte qenë i pranishëm së bashku bashkëshorten e tij në të gjitha takimet që z. A. B. (viktima e mashtrimit) kishte zhvilluar me ta, në lidhje me pasuritë e paluajtshme që ai do të mund të blinte;
  - ix. Gjithashtu, vlen të theksohet fakti që z. F. M. kishte qenë pronar i një pasurie tokë, që më pas ishte blerë nga viktima (z. A. B.), si dhe që ai më parë ishte dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, pikërisht për bashkëpunim në mashtrim, me bashkëshorten e tij;

<sup>7</sup> Për falsifikimin e dokumenteve të rezultuara joautentike dhe të përdorura për mashtrimet e konstatuara nga prokuroria, mund të kenë bashkëpunuar edhe persona të tjerë dhe nuk duket e arsyeshme që gjithçka ta ketë kryer e vetme znj. M. M. – e cila as nuk është proceduar për veprën e falsifikimit.

- x. Në konkluzion ritheksohet se Gjykata e Apelit Shkodër ka pasur kompetencën<sup>8</sup> dhe detyrën që – përballë një shkeljeje procedurale apo hetimeve/veprimeve ose akuzave të paplota të prokurorisë – të kërkojë nga prokuroria plotësimin e akuzës edhe mbi vepra të tjera penale dhe/ose të kthejë dosjen pas ose të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale – në bazë të neneve 372 – 375 të Kodit të Procedurës Penale – gjë që nuk rezulton të jetë bërë në rastin konkret nga subjekti;
- xi. Lidhur me gjetjet e Komisionit, subjekti është shprehur se:
  - a. nuk ka pasur asnjë provë lidhur me përfshirjen e shtetasit M. F. në mashtrim;
  - b. lehtësimi dhe pezullimi i dënimit për shtetasen M. M. është kryer duke pasur parasysh parimin e humanizmit dhe faktin që ajo ishte familjare dhe nënë fëmijësh;
  - c. mbi mosngritjen e akuzave të reja gjatë shqyrtimit të çështjes – lidhur me falsifikimin e akteve noteriale, firmave dhe dokumenteve të ZVRPP-së, si dhe certifikatave të pronësive të ndryshme – kjo nuk ishte kompetencë e gjykatës, por e prokurorisë, kjo akuzë nuk ishte ngritur as nga prokuroria dhe as nga Gjykata e Shkallës së Parë.

**Për sa më lart, Komisioni ka konstatuar mangësi profesionale, të konkretizuara në: mosvlerësim të të gjitha provave të administruara në dosje; arsyetim të dobët në vendim – kryesisht me shkaqet për të cilat z. F. M. duhej të mos konsiderohej i përfshirë në mashtrimin, objekt gjykimi; mosveprime për plotësimin e akuzës edhe me veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, të akteve noteriale, të vulave dhe të certifikatave të pronësisë – ndonëse këto ishin të provuara nga dokumentacioni i administruar në dosje – dhe në mosvlerësimin objektiv dhe koherent të disa rrethanave, si dhe në aplikimin jokorrekt të disa dispozitave ligjore – të cilat nuk rezultojnë në përputhje me provat dhe me rrethanat e kristalizuara nga hetimet dhe të pasqyruara në dokumentacionin e administruar në dosjen në fjalë.**

## **2. Procedimi civil nr. \*\*\*, viti 2013**

- i. Pasi është administruar dhe studiuar vendimi nr. \*\*\*, datë 20.2.2014, ka rezultuar se Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur pushimin e çështjes civile të reregjistruar me nr. \*\*\*, datë 11.1.2013;
- ii. Rezultoi gjithashtu se **ankimi** ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë **është bërë në muajin dhjetor të vitit 2012**, ku është kërkuar edhe pezullimi i këtij vendimi. **Gjykata e Apelit Shkodër**, ku vetë subjekti i rivlerësimit kishte dosjen në shqyrtim, **ka shqyrtuar dhe ka e shpallur vendimin në muajin shkurt të vitit 2014**;
- iii. Pra, ka pasur një tejkalim të pakuptueshëm të afateve për shqyrtimin e ankimit, për sa i përket pjesës që kishte të bënte me rivlerësimin e masës së sigurimit të padisë, që duhej të vendosej me procedurë të përshpejtuar dhe shumë më herët se vendimi në themel;
- iv. Por, është konstatuar se ka ndodhur e kundërta, pasi më herët është dhënë vendimi në themel, sesa ai mbi sigurimin e padisë së kërkuar në këtë çështje;

<sup>8</sup> Në bazë të pikës 5, të nenit 426/a dhe të neneve 373, 375 dhe 375 Kodit të Procedurës Penale.

- v. Lidhur me sa më lart, subjekti është shprehur se në Gjykatën e Apelit Shkodër, përgjatë viteve që ai ka drejtuar, nuk bëhej ndarja e çështjeve me objekt sigurinë e padisë nga ato që duhet të shqyrtohen në themel. Për rrjedhojë, kur i ka ardhur radha dosjes, ka rezultuar ndërkohë se çështja në Shkallë të Parë – për të cilën ishte kërkuar siguria e padisë – ishte pushuar. Komisioni mund të shqyrtojë me prioritet ato dosje për të cilat palët kërkojnë shqyrtim të përshpejtuar. Nëse pala në fjalë do të kishte paraqitur kërkesë te kryetari i gjykatës (që ishte vetë subjekti), atëherë dosja në fjalë mund të ishte shqyrtuar dhe vendosur më herët në afat.

**Nga sa më lart, Komisioni konstaton një mangësi profesionale, të konkretizuar në një vonesë shumë më përtej afatit të parashikuar, brenda të cilit subjekti duhej të kishte vendosur lidhur me rastin konkret. Po ashtu, mangësi vërehen edhe në lidhje me organizmin dhe planifikimin e punës – edhe në cilësinë e kryetarit të gjykatës – pasi organizimi dhe programimi i punës për shqyrtimin e dosjeve që lidhen me masa sigurie, nuk rezulton të jetë në përputhje me dispozitat procedurale që parashikojnë afate të ndryshme dhe shumë më të shkurtra për shqyrtimin e kërkesave për siguri padie.**

### **3. Procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2010**

- i. Pasi u administrua dhe u studiuua dosja në fjalë, rezultoi se ndaj një vendimi gjyqësor të Gjykatës së Apelit Shkodër, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues (për vendimin nr. \*\*\*, datë 20.5.2010, ishte paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*), datë 19.9.2012, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- ii. Gjithashtu, ka rezultuar se në datën 4.4.2006 është miratuar një lejë për shesh ndërtimi dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.6.2006 – nga KRRT-ja Shkodër është miratuar një leje ndërtimi për subjektet “\*\*\*” dhe “\*\*\*” për dy godina banimi me gjashtë kate, të ndodhura në lagjen “\*\*\*”;
- iii. Pas denoncimeve të bëra nga banorët që prekeshin/dëmtoheshin nga ky projekt, me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.12.2006, të Këshillit Bashkiak Shkodër është vendosur kthimi për rishqyrtim i lejeve të dhëna me vendimin nr. 7, të KRRT-së Shkodër;
- iv. Lidhur me këtë çështje është bërë edhe një kallëzim penal, pasi është evidentuar fakti se kjo lejë është dhënë në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi. Materiali për miratimin e kësaj leje ndërtimi është përgatitur nga zyra e urbanistikës dhe në këtë mbledhje kanë qenë të pranishëm edhe shtetasit F. Sh. dhe F. M.;
- v. Në procedimin penal, përveç dy personave të mësipërm, në ndjekje penale është marrë dhe drejtori i urbanistikës Shkodër, z. Gj. P. (anëtar i KRRT-së), për arsye se ai kishte qenë në dijeni se për këto objekte kishin filluar punimet para marrjes së lejes së ndërtimit dhe për më tepër kishte një vendim për pezullim punimesh;
- vi. Prokuroria ka ndjekur hapat proceduralë dhe ka marrë një ekspert të pavarur, ka pyetur subjekte të ndryshme, ndër to edhe personat e sipërpërmendur dhe ka sekuestruar provat materiale. Këta persona i ka thirrur me cilësinë e personave për të cilët ka filluar ndjekja për veprën penale “shpërdorim detyrë”;

- vii. Në përfundim të hetimit, duke vlerësuar se për këtë çështje prokuroria kishte evidentuar elemente të veprës penale “shpërdorim detyre”, ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dënimin e personave përgjegjës, F. Sh., F. M. dhe Gj. P.;
- viii. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi ka zhvilluar disa seanca gjyqësore, ka administruar provat përkatëse dhe, në përfundim me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.7.2009, ka vendosur:
- a. *Deklarimin fajtor të shtetasit F. Sh. për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe dënimin me 6 muaj burg dhe me 500,000 lekë gjobë. Ekzekutimi i dënimit pezullohet duke u vendosur në provë për një periudhë 3-vjeçare, me kusht që të mos kryhet ndonjë veprë tjetër penale. Heqja e së drejtës për ushtrim të detyrave shtetërore për një periudhë 1 vit dhe pagimi i gjobës, duhet të bëhet brenda 6 muajve.*
  - b. *Deklarimin fajtor të shtetasit F. M. për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe dënimin me 6 muaj burg dhe me 500,000 lekë gjobë. Ekzekutimi i dënimit pezullohet duke u vendosur në provë për një periudhë 3-vjeçare, me kusht që të mos kryhet ndonjë veprë tjetër penale. Heqja e së drejtës për ushtrim të detyrave shtetërore për një periudhë 1 vit dhe pagimi i gjobës duhet të bëhet brenda 6 muajve.*
  - c. *Deklarimin fajtor të shtetasit Gj. P. për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe dënimin me 6 muaj burg dhe me 500,000 lekë gjobë. Ekzekutimi i dënimit pezullohet duke u vendosur në provë për një periudhë 3-vjeçare, me kusht që të mos kryhet ndonjë veprë tjetër penale. Heqja e së drejtës për ushtrim të detyrave shtetërore për një periudhë 1 vit dhe pagimi i gjobës duhet të bëhet brenda 6 muajve.*
- ix. Kundër këtij vendimi personat e deklaruar fajtorë kanë bërë ankim dhe çështja gjyqësore është zhvilluar në Gjykatën e Apelit Shkodër me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Fuat Vjerdha, I. D. dhe L. D.;
- x. Prokuroria ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 27.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.5.2010, ka vendosur:
- a. *Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 27.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për sa ka disponuar për të pandehurin Gj. P.;*
  - b. *Prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 27.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me të pandehurit F. M. dhe F. Sh., si dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të tyre, pasi nuk vërtetohet fajësia e tyre.*
- xi. Për këtë vendim gjyqësor të Gjykatës së Apelit Shkodër, anëtari i trupës gjykuese L. D. ka qenë në pakicë, pasi sipas tij, provohej se nga të gjithë të pandehurit janë konsumuar elemente të veprës penale të shpërdorimit të detyrës;
- xii. Kundër këtij vendimi është bërë rekurs nga Prokuroria e Apelit Shkodër në Gjykatën e Lartë;
- xiii. Gjykata e Lartë në arsyetimin e vendimit të saj ka theksuar se:
- a. *“Vendimi i Gjykatës së Apelit, i cili ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me të gjykuarit M. dhe Sh., është rrjedhojë e një arsyetimi jo të plotë për vlerën e pronave të administruara, si dhe në zbatim të gabuar të ligjit material, duke arritur për rrjedhojë në përfundime jo të drejta dhe në shkelje të nenit 152, të Kodit të Procedurës Penale”;*

- b. *“Arsyetimi i kryer nga Gjykata e Apelit Shkodër, mbështetur në të njëjtat fakte dhe prova të administruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër se: “ ... ndonëse veprimet dhe mosveprimet e tyre përbëjnë mospërbushje të rregullt të detyrës, mungon lidhja shkakësore midis veprimeve apo mosveprimeve të tyre me pasojat e ardhura nga ndërtimi i këtyre dy objekteve ...” është i gabuar”;*
- c. *“Gjykata e Lartë vlerëson se, në të kundërt të asaj që ka arsyetuar Gjykata e Apelit Shkodër, veprimet dhe mosveprimet e të gjykuarve kanë lidhje të drejtpërdrejtë me pasojën e ardhur, legjitimitimin e ndërtimeve të dy objekteve, të cilat janë bërë në shkelje të ligjit dhe kanë cenuar edhe të drejtat e pronarëve kufitarë në këto dy objekte”.*
- d. Lidhur me këtë dosje, subjekti është shprehur se ai ka qenë dhe vijon të jetë i bindur që deklarimi i pafajshëm i dy prej tre të pandehurve ishte i duhuri, edhe pse vendimin e Gjykatës së Lartë do ta mbante në konsideratë në të ardhmen.

**Nga sa më lart, Komisioni vëren se në gjykimin e kryer nga Gjykata e Apelit Shkodër, në këtë çështje janë konstatuar këto mangësi profesionale: mungesë e vlerësimit të provave në harmoni me njëra-tjetrën dhe në mënyrë koherente; arsyetim i dobët mbi lidhjen shkak-pasojë. Bëhet fjalë për mangësi që bien ndesh me parimet dhe dispozitat ligjore, siç janë evidentuar dhe argumentuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila e ka prishur këtë vendim, duke lënë në fuqi atë të shkallës së parë.**

#### **4. Procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2007**

- i. Ka rezultuar se kjo çështje është përfunduar nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, ku subjekti Fuat Vjerdha ishte relator i çështjes. Me këtë vendim është lënë në fuqi vendimi i shkallës së parë, me dënimin e të pandehurit G. H. me 21 vite burg, për veprën penale të vrasjes me paramendim, në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake;
- ii. Denoncuesi shprehet se gjykimi i shtetasit G. H. nuk është i ligjshëm, pasi ai është dërguar në gjyq pa qenë më parë i cilësuar si i pandehur me vendimin, datë 14.9.2001, të prokurorisë – ku si i pandehur është marrë vetëm shtetasi V. H. – dhe pa u njohur me akuzën e ngritur ndaj tij vetëm para gjykatës, në shkelje të të drejtave themelore të të pandehurit, dhe për këtë arsye është regjistruar një proces në GJEDNJ-në në Strasburg. Ky pretendim, përgjatë hetimit administrative të Komisionit, rezultoi i pabazuar, pasi subjekti paraqiti dokumentin përkatës – vendimin e njoftimit të akuzës edhe për shtetasin G.H.;
- iii. Gjithashtu, vendimi konsiderohet i padrejtë nga denoncuesi, pasi nuk është bazuar mbi provat e marra përpara trupit gjykues gjatë shqyrtimit të çështjes, por vetëm mbi një deklaram përpara OPGJ-së, pa prezencën e avokatit. Veç të tjerash, ky deklaram nuk është konfirmuar përpara gjykatës, por është mohuar njohja e autorëve të krimit prej viktimës;
- iv. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër është paraqitur rekurs, por Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar atë, pa dhënë shumë shpjegime, por me tri fjali është shprehur: *“Rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale”* – ndërkohë që rekursi i referohej një prej shkaqeve të parashikuara nga ky nen, (mangësive procedurale);

Komisioni, pasi shqyrtoi dosjen, konstatoi se:

- v. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, duke dënuar me 23 vite burg të pandehurin V. H. dhe me 21 vite burg të pandehurin G. H.;
- vi. Nga një analizë e dy vendimeve në fjalë rezulton se fajësia e shtetasit G. H. bazohet vetëm në deklarinimin fillestar të kryer nga viktimja, shtetasi A. K., i cili pas ngjarjes, i pyetur vetëm nga OPGJ-ja – në spital ku ishte shtruar pas plagosjes – ka pohuar se ishte plagosur nga goditjet me armë nga tre persona, ndër të cilët, kishte njohur shtetasit V. H. dhe G. H., ndërsa personin e tretë nuk e kishte njohur;
- vii. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit Shkodër është marrë në pyetje personi i dëmtuar/plagosur, i cili ka pohuar se ai nuk ka njohur askënd nga personat që kanë qëlluar me armë në drejtim të tij;
- viii. Gjykata është shprehur se ajo e konsideron jo të besueshëm deklarinimin/qëndrimin e shtetasit A. K. përpara trupit gjykues, pasi ai vetë ka pohuar të kundërtën përpara OPGJ-së, dhe ky versioni i parë i tij është më bindës.

Komisioni, nga sa është përshkruar më sipër, vlerëson se:

**Ka pasur mangësi profesionale lidhur me procedurën e ndjekur, si dhe me mënyrën e marrjes së provave, pasi Gjykata e Apelit Shkodër, pasi ka dëgjuar dëshmitarin/viktimën (shtetasin A. K.), nuk e ka marrë për bazë provën e krijuar përpara trupit gjykues pa e argumentuar përse e kreu këtë dëgjësë, nëse ajo nuk ishte e rëndësishme, apo nëse mjaftonte çfarë kishte pohuar më herët i njëjti shtetas;**

**Kjo rrethanë mbart një rëndësi të veçantë, nga momenti që deklarimi i dhënë nga shtetasi A. K. përpara OPGJ-së rezulton të jetë e vetmja provë – në bazë të së cilës është dënuar G. H. me 21 vjet burg – e cila nuk rezulton të jetë marrë, sipas parashikimeve të nenit 362, të Kodit të Procedurës Penale dhe pa pasur garancinë e dokumentuar/certifikuar nga autoritetet shëndetësore që shtetasi A. K., gëzonte aftësi të plota psiko-fizike, fakt ky i domosdoshëm duke pasur parasysh vendin, rrethanat, mënyrën dhe kohën në të cilat është marrë kjo dëshmi, duke u konstatuar një gjykim i dobët nga subjekti;**

**Duket se marrja dhe përdorimi i provës në fjalë është kryer në kundërshtim me nenet 321, 322 dhe 362 të Kodit të Procedurës Penale, në bazë të të cilave prova duhet të formohet përpara trupit gjykues, dhe rastet përjashtimore janë të parashikuara në mënyrë taksative dhe ato duhet të argumentohen dhe motivohen – gjë nuk rezulton që të jetë bërë nga subjekti.**

## **5. Procedimi civil nr. \*\*\* i vitit 2018**

Komisioni, pasi ka administruar dhe ka studiuar të gjithë dokumentacionin e dosjes lidhur me çështjen nr. \*\*\* të vitit 2018, në Gjykatën e Apelit Shkodër, të konkluduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.3.2019, përfshirë këtu edhe regjistrimin audio të seancave gjyqësore (objekt denoncimi) dhe pasi ka dëgjuar edhe denoncuesin, shtetasin A. Gj., ka konstatuar se:

- i. Në seancën e datës 20.3.2019 gjatë një diskutimi midis palëve mbi legjitimitetin e paraqitjes së një prove të re, përfaqësuesi i Bashkisë Lezhë, pohon se dokumenti që ai po



- kërkon ta paraqesë si provë të re, i është kërkuar më herët nga kryetari (subjekti Fuat Vjerdha) që ta bëjë një gjë të tillë;
- ii. Nga dëgjimi i audios së regjistruar në seancën e mëparshme, të datës 27.2.2019, nuk rezulton një gjë e tillë, por kjo rrethanë konfirmohet edhe nga personi denoncues, i dëgjuar nga Komisioni, i cili pohoi se pasi ishte mbyllur regjistrimi audio në sallën e gjyqit, z. Fuat Vjerdha, i ka kërkuar përfaqësuesit të Bashkisë Lezhë që të sillte vendimin e Gjykatës Administrative, e cila kishte vendosur pezullimin e tij nga detyra. Ky fakt është pranuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit – pasi është njohur me denoncimin dhe me rezultatet – duke specifikuar se nuk e kishte bërë ai këtë kërkesë, por njëra prej anëtareve të trupit gjykues të kësaj çështjeje ku ai bënte pjesë;
  - iii. Ky qëndrim i subjektit të rivlerësimit, nga një anë konfirmon faktin e këshillës/kërkesës jashtë seancës formale, por nga ana tjetër bie ndesh me procesverbalin e seancës në fjalë dhe me pohimet e dy palëve ndërgjyqëse, të cilat, edhe pse në pozicione të kundërta interesi, përkojnë me njëra-tjetrën, pikërisht në pjesën: “... kryetari i ka kërkuar përfaqësuesit të Bashkisë Lezhë të sjellë si provë vendimin e Gjykatës Administrative mbi pezullimin nga detyra të shtetasit A. Gj.”;
  - iv. Ndërkohë që, sipas procesverbalit të seancës së datës 20.3.2019, trupi gjykues – pasi është tërhequr për të vlerësuar mbi kërkesën për marrjen e kësaj prove të re (vendimin e Gjykatës Administrative), të paraqitur nga pala e paditur – **ka vendosur rrëzimin e kërkesës në fjalë, duke argumentuar se avokatja e paditësit ka të drejtë që shprehet kundër kësaj kërkesë, pasi ajo provë duhej të ishte paraqitur me kohë, por megjithatë, trupi gjykues vendos të riçelë hetimin gjyqësor dhe ta marrë këtë provë, pasi ajo nuk mund të anashkalohet pa u marrë në shqyrtim, sepse çmohet e domosdoshme për këtë gjykim;**
  - v. Qëndrimi i mësipërm i Gjykatës së Apelit rezulton të jetë kontradiktor, i paqartë dhe jo në përputhje me ligjin, duke lënë përshtypjen se trupi gjykues – pasi ka konstatuar pabazueshmërinë e kërkesës procedurale të një pale ndërgjyqësore, i mbyll derën marrjes së një prove të re – por në njëfarë mënyre, vetë gjykata realizon qëllimin e palës, duke hapur një dritare për të mundësuar hyrjen e provës së re në dosjen gjyqësore, në mosrespektim të dispozitave procedurale në fuqi;
  - vi. Për më tepër, duhet theksuar se kjo provë e re jo vetëm që nuk ka qenë e domosdoshme për vendimmarrjen në fjalë, por ajo nuk ka asnjë pikëlidhje me objektin e gjykimit që ishte duke kryer subjekti me kolegët e vet (veç subjekteve ndërgjyqëse), pasi vendimi i Gjykatës Administrative ka vlerësuar dhe është shprehur mbi një pezullim të dhënë ndaj denoncuesit, për shkak të një diskutimi dhe përballjeje me një koleg në zyrën e vet, ndërsa vendimi i punëdhënësit, për largimin e denoncuesit nga puna, bazohej në një parregullsi formale në kontratën kolektive të punës, të ngritur nga Inspektorati i Shërbimit Civil. Dhe pikërisht bazuar në këto parregullsi formale, Bashkia Lezhë kishte zgjidhur në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme – pa paralajmërim – të gjitha kontratat në fjalë (rreth 20). Për rrjedhojë, arsyeja e pezullimit dhe vendimi i Gjykatës Administrative nuk kishin asnjë lidhje shkakore me objektin e çështjes që ishte duke shqyrtuar subjekti Fuat Vjerdha;
  - vii. Lidhur me këtë fakt, në shpjegimet e tij, subjekti është shprehur se, meqenëse Kodi i Procedurës Civile ishte ndryshuar jo shumë kohë më parë, trupi gjykues vlerësoi ta refuzonte kërkesën e palës në zbatim të dispozitave të kodit të ri. Gjithashtu, e pa të arsyeshme që të merrte kryesisht provën e kërkuar, meqenëse edhe në gjykimin e shkallës

së parë ishte kërkuar dhe i ishte dhënë kohë për administrimin e kësaj prove, por pala nuk e kishte paraqitur;

- viii. Iniciativa e Gjykatës së Apelit, për të administruar kryesisht një provë të re, në mungesë të kushteve taksativisht të parashikuara për këto raste, rezulton të jetë kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore që parashikojnë mënyrat dhe kushtet e marrjes së një prove të re dhe të çeljes së hetimit gjyqësor nga ky organ gjyqësor – neni 465 i Kodit të Procedurës Civile;
- ix. Nga rrethanat dhe kushtet e sipërpërshkuara, në të cilat ka vepruar subjekti i rivlerësimit kur ka vendosur marrjen e kësaj prove të re, nuk duket që të konstatohet ekzistenca e ndonjërit nga rastet e parashikuara në mënyrë taksative nga pika 5, e nenit 465, e Kodit të Procedurës Civile;
- x. Marrja dhe përdorimi i kësaj prove të re, nëpërmjet një procedure jo të rregullt, veç të tjerash rezulton se ka ndikuar thelbësisht në vendimmarrjen në fjalë, duke e deformuar atë në njëfarë mënyre dhe duke e rënduar kështu pasojën e administrimit të saj në dosjen gjyqësore, jo në përputhje me rregullat procedurale;
- xi. Për më tepër, në mungesë të plotë të logjikës juridike dhe në mosrespektim të kornizës procedurale që përkufizon kompetencat, detyrat dhe hapësirat në lidhje me objektin e kërkesës, brenda të cilave duhet të shprehet një gjykatë, subjekti – pasi e ka administruar jo në përputhje me normat procedurale – ka përdorur një vendim të një gjykate administrative, e cila më herët ishte shprehur mbi ligjshmërinë e një vendimi pezullimi nga puna të një subjekti për një shkak të caktuar, i cili në çështjen në fjalë – që po shqyrtonte Gjykata e Apelit Shkodër – kishte paditur më pas të njëjtin punëdhënës, por këtë herë me objekt *“pavlefshmërinë e urdhrin të lirit të paligjshëm nga puna”*, ku shkakun i ndërprerjes së marrëdhënies së punës ishte krejt i ndryshëm me shkakun për të cilin ishte urdhëruar pezullimi. Pra, ndodhemi përballë një kapërcimi të kompetencave, me mosrespektim të dispozitave procedurale dhe mosrespektim të objektit të padisë, përtej mungesës së argumentimit dhe motivimit të vendimit në fjalë.

**Nga sa më lart Komisioni vlerëson se subjekti, në këtë rast, ka kryer shkelje procedurale duke evidentuar mangësi të rënda dhe të shumëfishta profesionale, që lidhen: me mënyrën e marrjes së provave në kundërshtim me nenin 465, të Kodit të Procedurës Civile, përtej kompetencës; me administrimin dhe përdorimin e një prove që nuk kishte lidhje me objektin e çështjes që po shqyrtohej; me gjykim të dobët, argumentim dhe mbështetje të vendimit mbi një provë që është jashtë objektit të gjykimit; me dhënie sugjerimesh/këshillash apo kërkesa nga gjyqtari (jashtë seancës gjyqësore formale, me mikrofonta të fikur), në favor të njëjës palë dhe në dëm të tjetrës, gjatë dhe në lidhje me një proces gjyqësor që ai gjykon; me etikën dhe mosrespektimin e pikës 4, të nenit 72, të Kodit të Procedurës Civile, për dorëheqjen e gjyqtarit, në vijim të faktit të sipërcituar; me shkelje të të drejtave të njëjës palë në favor të palës tjetër.**

**Gjithashtu, Komisioni çmon se këto shkelje lidhen me procedurat e gabuara dhe joetike të ndjekura përgjatë një procesi gjyqësor dhe kanë cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.**

## **6. Procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2011 – fakt i njohur botërisht**

Ka rezultuar se Gjykata e Apelit Shkodër kishte vendosur ndryshimin e vendimit për të pandehurin S. M. nga 10 vjet burg, me 4 vjet burg. Subjekti i rivlerësimit, z. Fuat Vjerdha, ka qenë anëtar në trupin gjykues që kishte marrë këtë vendim. Pas studimit të dosjes së administruar nga Komisioni, më herët është konstatuar se:

- i. Kjo ngjarje e ka filluesën në shtator të vitit 2010, kur u vra me mjete të forta 13-vjeçari A. L. Të dyshuarit, pasi ishin gjykuar nga Gjykata e Rrethit, në Gjykatën e Apelit janë gjykuar nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: M. H., Fuat Vjerdha dhe L. D.;
- ii. Për vlerësimin e përfshirjes profesionale të subjektit Fuat Vjerdha në këtë çështje janë përdorur edhe konkluzionet e inspektimit të kryer në Gjykatën e Apelit Shkodër, lidhur me çështjen penale në ngarkim të të gjykuarit S. M., konkluzione të cilat janë përcjellë me shkresën nr. \*\*\*, datë 4.10.2018, të Ministrisë së Drejtësisë;
- iii. Në raportin për inspektimin e kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër në korrik të vitit 2015 përcaktohet se gjatë këtij inspektimi u kontrollua veprimtaria procedurale penale dhe administrative e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe e Gjykatës së Apelit Shkodër në gjykimin e çështjeve penale me të pandehur S. M. dhe ka rezultuar sa vijon:
- iv. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.12.2011, ka vendosur ndër të tjera: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit S. M. për kryerjen e veprës penale të ‘vrasjes së kryer në rrethana të cilësuar’, të kryer ndaj të miturit në bashkëpunim dhe, në bazë të neneve 79/a, 25 dhe 51 të Kodit Penal, dënimin e tij me 10 vjet burgim...”*
- v. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga të pandehurit dhe avokatët e tyre;
- vi. Gjykata e Apelit Shkodër ka regjistruar çështjen në regjistrin themeltar penal me nr. \*\*\* dhe në sistemin elektronik ICMIS me nr. \*\*\*, datë 9.2.2012 dhe në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.1.2013, ka vendosur për të pandehurin S. M., ndryshimin e vendimit:
  - a. *Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të sigurimit të kushteve për të kryer vrasje dhe në bazë të nenit 80 dhe 52 të Kodit Penal e dënon me 2 vjet e 6 muaj burgim;*
  - b. *Deklarimin fajtor të pandehurit për veprën penale “moskallëzim krimi” dhe në bazë të nenit 300 dhe 51 të Kodit Penal e dënon me 1 vit e 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal e dënon përfundimisht të pandehurin me 4 vjet burgim;*
- vii. Gjykimi i kësaj çështjeje ka zgjatur për një periudhë kohore prej 10 muajsh e 21 ditë nga momenti i kalimit të çështjes me short, pra, jashtë afatit 9-mujor të përcaktuar në vendimin nr. \*\*\*, datë 14.4.2010, aneksi 1, të KLD-së;
- viii. Të gjitha seancat gjyqësore kanë filluar me vonesë, pa u pasqyruar në procesverbal shkaku i vonesës, duke shkelur rregullin 8 të Kodit të Etikës Gjyqësore, miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare në datë 8.12.2006, dhe nenin 4 të vendimit nr. 238/1/b, datë 24.12.2008, të KLD-së. Kjo praktikë e gabuar ka sjellë për pasojë uljen e transparencës së zhvillimit të gjykimeve në këtë gjykatë;
- ix. Gjykata, në arsyetimin e saj, citon se i pandehuri S. M. nuk ka bashkëpunuar në vrasje, por u ka krijuar kushte dy të pandehurve të tjerë për ta kryer krimin dhe, për këtë, duhet të

përgjigjet për veprën penale të parashikuar nga neni 80 i Kodit Penal dhe ai i moskallëzimit të krimit të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal;

- x. Janë konstatuar shkelje të pikave 1 dhe 2, të nenit 152, të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin parashikohet: “1. Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe i fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. 2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën”; dhe të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin parashikohet: “Me vendimin përfundimtar gjykata mund t’i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose i dëmtuari akuzues, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj”;
- xi. Duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës, gjykata ka lehtësuar pozitën e të pandehurit dhe, për më tepër, pas përsëritjes së pjeshme të hetimit gjyqësor nuk rezulton që nga analiza e vlerësimit të fakteve dhe të dëshmive të dëshmitarëve të pyetur të kenë diktuar gjykatën për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës;
- xii. Në aplikim të nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata e Apelit Shkodër ka vijuar duke e përsëritur pjesërisht hetimin gjyqësor dhe, në përfundim të gjykimit, i ka dhënë faktit një përcaktim juridik të ndryshëm nga ai i prokurorit dhe i vendimit të shkallës së parë, lidhur me njërin prej të akuzuarve. Për të gjykuarin S. M., gjykata ka bërë ndryshim të kualifikimit ligjor nga vepra penale “*vrasje në rrethana të tjera cilësuese*” e kryer ndaj të miturit në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 79/a dhe 25 të Kodit Penal, në veprat penale “*sigurim i kushteve për të kryer vrasje*” dhe “*moskallëzim krimi*”, parashikuar nga nenet 80 e 300 të Kodit Penal, duke lehtësuar në këtë mënyrë pozitën e të pandehurit;
- xiii. Ligjërisht ky veprim është në kompetencën e kësaj gjykate dhe harmonizohet me përmbajtjen e nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale. Por, në analizë dhe në përputhje me faktet dhe me provat e shqyrtuara në seancë gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe të argumentuara në vendimin e saj, ky ndryshim i cilësimit juridik të veprës penale prej Gjykatës së Apelit Shkodër nuk është bindës dhe argumentues, pasi, pas përsëritjes së pjeshme të hetimit gjyqësor nga kjo gjykatë nuk rezulton që nga analiza e vlerësimit të fakteve dhe të dëshmive të dëshmitarëve të pyetur, të mund të diktonin gjykatën për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës, në kundërshtim me parashikimet e pikave 1 dhe 2, të nenit 152, të Kodit të Procedurës Penale;
- xiv. Gjykata, në ushtrimin e funksionit të saj juridiksional, duhet të sqarojë kuptimin e ligjit që duhet të zbatohet, me qëllim që të eliminojë çdo dyshim që lidhet me cilësimin juridik të veprës, për të siguruar kështu stabilitetin e së drejtës dhe rivendosjen e rendit të shkelur juridik;
- xv. Lidhur me vendimin e gjykatës për cilësimin e ri të veprës penale “*sigurim i kushteve për të kryer vrasje*”, vlerësojmë se për të ekzistuar kjo akuzë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative të dy elementet e saj: sigurimi i kushteve dhe për të kryer vrasje;
- xvi. Gjatë shqyrtimit, Gjykata e Apelit Shkodër shprehet se i gjykuari S. M. i ka siguruar kushtet, por nuk është vërtetuar se ai kishte dijeni se ndaj viktimës do të kryhej vrasja;
- xvii. Pra, ky ndryshim dhe cilësim i ri nuk qëndron, pasi nuk plotësohet njëri nga elementet e kërkuara në dispozitë – dijenia e S. M. se do të kryhej vrasja.

Në konkluzion të vlerësimeve, si më lart, të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, pohohet:

1. Gjyqtarët M. H., Fuat Vjerdha dhe L. D., në çështjen me vendim nr. \*\*\*, nuk kanë respektuar vendimin nr. \*\*\*, datë 14.04.2010, aneksi 1, të KLD-së, pasi kanë gjykuar çështjen 21 ditë përtej afatit 9-mujor të përcaktuar në këtë akt nënligjor;
  2. Gjyqtarët M. H., Fuat Vjerdha dhe L. D., në çështjen me vendim nr. \*\*\*, nuk kanë respektuar nenin 379 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit marrja e vendimit nuk mund të shtyhet, përveçse në rast pamundësie absolute dhe shtyrja vendoset nga kryetari me urdhër të motivuar, pasi trupi gjykues e ka shtyrë seancën e parafundit gjyqësore pa qenë në kushtet e pamundësisë absolute për të dhënë vendimin e, për më tepër, pa urdhër të motivuar të kryetarit të seancës për shtyrjen e seancës për shpalljen e vendimit të arsyetuar;
  3. Gjyqtarët Fuat Vjerdha, M. H., dhe L. D., në çështjen me vendim nr. \*\*\*, nuk kanë respektuar parashikimet e pikave 1 dhe 2, të nenit 152, të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale;
  4. Gjykimi i kësaj çështjeje ka zgjatur për një periudhë kohore prej 10 muaj e 21 ditësh nga momenti i kalimit të çështjes me short, pra, përtej afatit 9-mujor të përcaktuar në vendimin nr. \*\*\*, datë 14.4.2010, të KLD-së. Nga ky fakt duket sikur subjekti nuk ka qenë i aftë të përballojë ngarkesën e punës;
  5. Të gjitha seancat gjyqësore kanë filluar me vonesë, pa u pasqyruar në procesverbal shkaku i vonesës së tyre, duke shkelur rregullin 8 të Kodit të Etikës Gjyqësore, miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare në datën 8.12.2006, dhe nenin 4 të vendimit nr. 238/1/b, datë 24.12.2008, të KLD-së. Nga kjo praktikë e gabuar duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka aftësi për të kryer procedura gjyqësore dhe ka sjellë për pasojë uljen e transparencës së zhvillimit të gjykimeve në këtë gjykatë;
  6. Me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga trupi gjykues dhe, për rrjedhojë, uljen e dënimit nga 10 vjet në 4 vjet, është cenuar integriteti i trupit gjykues në lidhje me imunitetin ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, duke pasur parasysh se rezultati i inspektimit nga Ministria e Drejtësisë është si vijon: “Ka shkelje të pikave 1 dhe 2, të nenit 152, të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin parashikohet se çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe i fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi;
  7. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën; dhe nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin parashikohet se me vendimin përfundimtar gjykata mund t’i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose i dëmtuari akuzues, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj;
  8. Duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës, gjykata ka lehtësuar pozitën e të pandehurit dhe, për më tepër, pas përsëritjes së pjesshme të hetimit gjyqësor nuk rezulton që nga analiza e vlerësimit të fakteve dhe të dëshmimeve të dëshmitarëve të pyetur, të kenë diktuar gjykatën për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës.”
- xviii. Lidhur me sa më lart, subjekti ka pohuar se trupi gjykues është shprehur në bazë të bindjes së brendshme, të cilën ai vijonte ta kishte ende mbi mosbashkëpunimin e të miturit S. M.

në vrasjen në fjalë. Gjithashtu, ai ka shtuar se ndoshta ka qenë i gabuar vlerësimi mbi akuzën “sigurim i kushteve për të kryerjen e vrasjes”, pasi me këtë pjesë të dënimit ai është penalizuar nga trupi gjykues dhe kursesi ai nuk ka qenë i favorizuar prej saj/tij.

**Komisioni çmon se faktet e mësipërme, si dhe konstatimet e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, si më lart, evidentojnë disa mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe vetë – në shpjegimet e tij – e ka pranuar se riformulimi i cilësimit të veprës penale ka qenë i gabuar (edhe pse me efekt penalizues dhe jo favorizues ndaj të pandehurit).**

Gjithashtu, nga konstatimet e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë rezulton se subjekti ka shkelur rregullën nr. 8 të Kodit të Etikës Gjyqësore; nenin 4 të vendimit nr. 238/1/b, të datës 24.12.2008, të KLD-së; pikat 1 dhe 2, të nenit 152 dhe nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale.

Së fundmi, këto shkelje lidhen me procedurat e gabuara dhe joetike të ndjekura përgjatë një procesi gjyqësor dhe kanë cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

**Në konkluzion, duke mbajtur parasysh se:**

**A. Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme në deklaratën “Vetting” dhe nuk ka justifikuar në mënyrë bindëse mospërputhjen e kësaj të fundit me deklaratat periodike, lidhur me kursimet *cash* dhe gjendjet likuiditet në llogaritë bankare, sipas parashikimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016; për rrjedhojë nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklaramit të pasurisë dhe duhet aplikuar pika 5, e nenit D, e Aneksit të Kushtetutës.**

**B. Lidhur me kontrollin e figurës subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm, sipas germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, dhe, për rrjedhojë, për sa i përket figurës, ai konsiderohet i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

**C. Lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit janë konstatuar mangësi profesionale të përsëritura, shkelje procedurale dhe gjykim i dobët, për shkak të të cilave subjekti nuk arrin nivelin kualifikues të kërkuar sipas germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar pika 4, e nenit 61, e ligjit nr. 84/2016.**

**D. Nga vlerësimi tërësor dhe kryesisht për sa i takon aspektit etiko-profesional, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, ndaj, për rrjedhojë, duhet aplikuar edhe pika 5, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës, në nenin D, të Aneksit të Kushtetutës; në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikave 3, 4 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. **Fuat Vjedha**, me funksion gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Apelit Shkodër.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 10.6.2019.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Olsi Komici**

**Kryesues**

**Lulzim Hamitaj**

**Relator**

**Pamela Qirko**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*

*Anisa Duka*